



AGJENCIA KOMBËTARE E
PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
Nr. 66901 Prot.
Datë 10.06.2024



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË
NË TURİZËM DHE MJEDIS
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR, LEJEVE DHE LICENSAVE

Nr. 4012 / Prot.
3

Tiranë, më 9.9.2024

Lënda: Deklaratë mjedisore

Z. Tërmët PEÇI
Kryetar i Bashkisë
BASHKIA TEPELENË
Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë, Shqipëri

Për djeni:



Znj. Adelina GRECA
Drejtore i Përgjithshëm


AGJENCIA E KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
Rruja "Muhamet Gjollesha" nr. 57, Tiranë.

Referuar kërkesës Tuaj, protokolluar në Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) me nr. 4012 prot., datë 14.06.2024, për pajisje me Deklaratë mjedisore për "Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tepelenë", bashkëlidhur gjeni deklaratën e ministrit.

Duke ju falënderuar,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Ledina BEQIRAJ AGALLIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

80
Vjetor i Lirimit

Nr. 4012/2 prot.

Tiranë, më 2. P. 2024

DEKLARATË MJEDISORE
për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Në mbështetje të nenit nr. 12 të ligjit nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor" dhe akteve nënligjore që trjedhin prej tij, ministri lëshon këtë Deklaratë Mjedisore për:

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR, BASHKIA TEPELENË

Kufijtë e zonës që mbulon Plani: sipërfaqja në administrim të Bashkisë Tepelenë.

Autoriteti propozues: Bashkia Tepelenë.

Përdorimi i deklaratës mjedisore:

Deklarata Mjedisore nuk përjashton detyrimin, që për projekte të veçanta të parashikuara në këtë Plan, t'i nënshtrohen kërkesave të legjisacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, për lejet e mjedisit dhe akteve të tjera normative në fuqi.

Qëndrimi i ministrisë lidhur me propozimin:

Duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapsinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, plani në tërsi, si dhe të gjitha praktikat që do të realizohen janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor. Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) ndjek në përgjithësi të gjithë kuadrin ligor në fuqi "Për mbrojtjen e mjedisit".

Përputhja e PPV me objektivat e mbrojtjes së mjedisit, si dhe legjisacionin mjedisor:

Plani i propozuar në parim përputhet me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe plotëson kërkesat e legjisacionit mjedisor në fuqi, si ai për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit dhe zonat e mbrojtura, për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së së ujrale, menaxhimin e integruar të mbetjeve, ndryshimet klimatike, për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave, menaxhimin e zhurmave në mjedis, gazet serrë etj.

Gjatë hartimit të propozimeve për PPV-në, i është dhënë rëndësi e veçantë shhangies së infrastrukturës masive, shfrytëzimit racional të burimeve ujore-dhe-natyrore, -dhe-të-sigurohet zhvillim i qëndrueshëm i territorit. Drejtimet kryesore për zhvillimin e territorit të bashkisë Tepelenë kanë si synim të nxisin potencialin aktual dhe prespektiv duke ndërmarrë veprimet e duhura për mbrojtjen e mjedisit, përdorimin racional të tokës, prosperitetin ekonomik, restaurimin dhe rritjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, dhe duke konsideruar rëndësinë e ruajtjes së shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit.

Qëllimi i këtij plani si dhe objektivat e tij, janë të pozicionuara mirë dhe përbëjnë një bazë të mirë për të krijuar përputhshmëri më të madhe me objektivat mjedisore në vijim të praktikave që do të realizohen brenda periudhës 15 vjecare të këtij plani të përgjithshëm vendor.

Është marrë parasysh dhe është integruar përputhshmëria me disa plane apo programe themelore sikurse Plani i Përgjithshëm Kombëtar "Shqipëria 2030", Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit në Mjedis, Plani

Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, Plani Kombëtar i Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave në Mjedis, Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit, Plani i Integruar i Menaxhimit të Parkut Kombëtar Lumi Vjosa etj.

Në kuadër të këtij vlerësimi mjedisor u identifikuani ndikimet negative dhe pozitive, dhe mundësitet e shfaqjes së ndikimeve, shkalla e tyre, shpeshtësia e shfaqjes së tyre dhe kohëzgjatja, kthyeshmëria, karakteri i tyre ndërkufitar, karakteri i tyre kumulativ ose synergjik etj.

Ky plan i përgjithshëm vendor është përgatitur me qëllim përfshirë paraqitur vizionin, misionin, qëllimin e politikave dhe Planet e Veprimeve në Shqipëri në mënyrë të qartë, specifike sasiore dhe kohore, në përputhje me anagazhimet e vendit tonë drejt arritjes së Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Objektivat kryesorë që synohet të përmblidhet PPV e bashkisë Tepelenë në 15 vitet e ardhshme janë:

- Të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit nëpërmjet përdorimit racionall të tokës dhe të burimeve natyrore.
- Të vlerësojë potencialin aktual dhe atë prospektiv përfshirë zhvillimin e territorit duke balancuar burimet natyrore, nevojat ekonomike dhe njerëzore, gjithashtu edhe interesat publike dhe privatë.
- Të nxise veprimet e duhura përmblidhet, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashgimisë natyrore e kulturore dhe përfshirë biodiversitetin dhe të peizazhit.
- Të mundësojë të drejtën e përdorimit dhe të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislacionin në fuqi.
- Të krijojë kushte të përshtatshme, të drejta dhe shance të barabarta përmblidhet, veprimtarinë ekonomike dhe sociale, kohezion ekonomik e social dhe gjëzimin e të drejtave të pronësisë.

Objektivat strategjikë mjedisorë

Raporti Mjedisor përcakton fushat dhe objektivat mjedisore të rëndësishme si më poshtë:

- **Objktivi mjedisor 1:** Sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm të tokës. Ruajta e cilësisë, sasisë dhe funksionin e tokës duke përfshirë edhe tokat e vlefshme bujqësore.
- **Objktivi mjedisor 2:** Parandalimi dhe reduktimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit/reabilitimit të infrastrukturës.
- **Objktivi mjedisor 3:** Përshtatje e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë.
- **Objktivi mjedisor 4:** Kompletimi i infrastrukturës së mbetjeve, lendfilave dhe inceneratorëve. Reduktimin e sasisë së depozitimit të mbetjeve në lendfile nëpermjet proceseve të reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit.
- **Objktivi mjedisor 5:** Ruajta e cilësisë së ajrit në qendrat e banuara dhe emetimeve të ndotësve atmosferikë përfshirë arritjet përputhshëm me kufijtë maksimale të lejueshëm nga BE përmblidhet e ndotësve atmosferikë.
- **Objktivi mjedisor 6:** Parandalimi i përkeqësimit, mbrojtja dhe kur është e mundur përmirësimi i mjedisit ujor. Kufizimi i efekteve negative mbi ujrat sipërfaqësor dhe nëntokësorë.
- **Objktivi mjedisor 7:** Ruajta dhe përmirësimi i llojeve, habitateve të tjera të mbrojtura dhe shërbimeve natyrore të padëshiruara në biodiversitetin.
- **Objktivi mjedisor 8:** Parandalimi/Reduktimi i ndotjes së mjedisit nga zhurmat dhe përafrimi me nivelet e rekomanuara nga BE.
- **Objktivi mjedisor 9:** Shëndeti publik.
- **Objktivi mjedisor 10:** Mbrojtja dhe, kur është e mundur, përmirësimi i karakterit, diversitetit dhe cilësive të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit historik.

- **Objektivi mjedisor 11:** Mbrojtja dhe përmirësimi i peizazheve të jashtëzakonshme dhe zonave me peizazhe me karakteristika të veçanta dalluese në nivel kombëtar. Shmangia e efekteve negative në peizazhet e mbrojtura dhe krijimi i një imazhi me cilësi të lartë.

Arsyetimi se si janë marrë në konsideratë mendimet e publikut për pasojat në mjedis të Planit të propozuar:

Në kuadër të procesit të VSM-së, bashkia Tepelenë është pajisur me dokumentin e Deklaratës Mjedisore më datë 26.05.2021 me nr. 3523 prot., për Planin e Përgjithshëm Vendor të saj. Në zbatim të pikës 9, neni 12 i ligjit nr. 91/2013, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategik Mjedisor”, nëse plani nuk miratohet brenda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore, atëherë deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-Së fillon nga e para.

E ndodhur në këto kushte bashkia Tepelenë ka rinisur procedurën për VSM-në të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Në kuadër të procesit të VSM-së janë organizuar 2 dëgjesa me publikun dhe palët e interesuara në fazat përkatëse të tij dhe të riaplikimit për deklaratën mjedisore. Gjatë këtyre takimeve janë diskutuar dhe adresuar problematika të ndryshme mbi potencialet e zhvillimit të zonës, agroturizmin, gjendjen e infarstrukturës rrugore e cila është faktor kyç për lidhjen e zonave të thella rurale me qendrën e bashkisë, rritja e investimeve publike dhe private, me qëllim rritjen e punësimit dhe rritjen e nivelit të jetesës, etj. Rëndësi të vecantë i është kushtuar impaktit mjedisor, social dhe ekonomik që ka shpallja e Vjosës Park Kombëtar i Kategorisë së II-të. Janë evidentuar anët pozitive dhe kujdesi qe duhet treguar në mbarëvajtjen e kësaj kategorie të mbrojtjes në bazë të ligjit Nr. 21/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, si dhe VKM-në nr. 155, datë 13.03.2023, Këshilli i Ministrave vendosi: “Për shpalljen e Ekosistemit Natyror Lumit Vjosa “Park Kombëtar”, Kategoria II.

Në takimet e realizuara me publikun dhe grupet e interesit të përfshira në procesin e VSM-së PPV-së për bashkinë Tepelenë, ka rezultuar se ky plan është pritur me pozitivitet nga komuniteti dhe palët e interesuara. Përveç përfshirjes së institucioneve në nivel qëndror, që janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe për sektorin e planifikimit të territorit, në dëgjesë janë përfshirë edhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave për sektorin e menaxhimit të turizmit, mjedisit, ujrale, mbetjeve, si dhe ato të planifikimit të transportit apo shëndetit publik.

Pjesë e rëndësishme e procesit të konsultimit kanë qenë edhe pëfaqësues të stafit të bashkisë, pëfaqësues biznesesh, pëfaqësues të organizatave joqeveritare, ekspertë të fushave të ndryshme. Përfshirja efektive e grupeve përkatëse të interesit ka kontribuar në cilësinë e vlerësimit, ka sjellë të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-së dhe do të mbështesë zbatimin e PPV-së pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve përkatëse. Komentet e grupeve të interesit janë marrë parasysh kryesisht në përcaktimin e masave zbutëse për zbatimin e planit.

Ndikimet e mundshme në mjedis të planit:

Gjatë zbatimit të planit të përgjithshëm vendor, priten ndikime pozitive dhe negative.

- Ndikimet pozitive priten në zhvillimin e infrastrukturës, ndërtimit/modernizimit të strukturave të reja apo ekzistuese, në përmirësimin e mirëqenies dhe shëndetit të popullatës. Pjesa pozitive e impakteve mbi popullaten dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës në përgjithësi, që do të bëjë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafshimin me qendrat urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.
- Ndryshimet në sasinë e ujit apo të rrjedhës natyrore identifikojnë efekte të mundshme pozitive për përmirësimin nëpërmjet menaxhimit të përmbytjeve, vecanërisht në zonat ku trupat ujorë vlerësohen si të dëmtuar për shkak të gjëndjes së tyre fizike.

Përgjithësia e impakteve negative do të janë të lidhur me fazën e zbatimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapsirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme) pasi zona ka vecori të theksuara dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peizazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjerë dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, mbetje, agro-turizëm, etj).

- Ndiqime negative në shëndetin dhe cilësinë e jetës së polullatës mund të ndodhin si pasojë e shtimit të ndotjes nga zhurmat, ndikimet në cilësinë e ajrit, sidomos në zonat me densitet të lartë banimi, gjatë fazës së zbatimit të projekteve specifike.
- Zhurma ka ndikim negativ veçanërisht për shpendët dhe gjitarët dhe ky ndikim nuk është i pranishëm vetëm në distancë të afërt me aktivitetin, por përhapet edhe mjaft më gjërë.
- Përshtatja e ndërtimeve dhe infrastrukturës së re, mund të shkaktojnë ndikim të konsiderueshëm negativ në cilësinë (apo shkatërrim të pakthyeshëm) të tokës.
- Mund të evidentohet humbje të sipërfaqeve të vogla, fragmentizim të tokës bujqësore, pyjore, ndotje të saj dhe potencial për erozion.
- Pozicionimi i vendosjes së strukturave të reja në hapsira të hapura dhe me natyrë ruajtjen e biodiversitetit mund të sjellë ndërhyrje direkte në aktivitetet e vazhdueshme të zonave pyjore të cilat duhe të kryejnë funksionet vegjetative bimore me anë të drurëve si aktivitet primar (dëmtime të pakthyeshëm).
- Ndryshime apo dëmtime në cilësinë e ujit dhe funksionimin natyror të baseneve ujore.
- Impaktet mbi ujrat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, burimet e ujit të pijshëm (ndryshim të elementeve cilësore dhe statusit ekologjik të ujraleve), përgjatë periudhës së rindërtimit apo ndërtimit të infrastrukturave të reja.
- Pozicionimi në zonat e burimeve ujore të mbrojtura.
- Fragmentimi i habitateve natyrore dhe biodiversitetit, dëmtimi i jetës së egër si pasojë e mbishfrytëzimit apo keqmenaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe shkarkimi të pakontrolluar të ujraleve të ndotur apo substancave të rrezikshme.
- Humbje të zonave të habitatit dhe llojeve të habitatit, përfaqësuesëve individualë të llojeve të bimëve dhe kafshëve.
- Në zonat ku nuk merren masa mbrojtëse ekziston mundësia e konflikteve mes infrastrukturës së ngritur dhe gjitarëve gjatë lëvizjeve ditore dhe amfibëve që lëvizin gjatë sezonit të migrimit. Dëmtime të rregullta dhe të shpeshta mund të shkaktojnë gjithashtu rënien të përmasave të pupullatave.
- Sasira të mëdha mbetjesh mund të përdoren veçanërisht në ndërtimet e rrugëve dhe infrastrukturave të ngjashme ku materialet mbushëse janë mjaft të nevojshme.
- Degradimi i vëçorive të peizazhit përreth njësive të trashëgimisë kulturore.
- Shkatërrim i mbetjeve arkeologjike gjatë fazës së ndërtimit.
- Thatësira të shpeshta të gjata dhe me rrezik zjarri janë të mundshme.

Masat zbutëse që duhet të merren për mbrojtjen e mjedisit:

Me qëllimin për të shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis të planit në të gjithë fazat e tij duhet të zbatohen me përpikmëri të gjitha masat e mëposhtme:

- T'i jepet përparësi rindërtimit të infrastrukturave ekzistuese para ndërtimeve të reja gjatë planifikimit të projekteve.
- Të zbatohen kërkjesat në afatet e përcaktuara kohore të legjislacionit të mbetjeve në fuqi, si dhe të bashkëpunojnë në kuadër të rrjetit të integruar të instalimeve, në përputhje me nenin 22 , të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, për të bërë të mundur grumbullimin maksimal të diferencuar të mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin ose depozitimin në instalimet më të afërtat, të përshtatshme me metodat dhe teknologjitë e nevojshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mjedor dhe të mbrojries së shëndetit publik.
- Vëmendje e veçantë t'i kushtohet planifikimit të menaxhimit, për integrimin e zonave të sigurisë nga përblytjet dhe atyre ligatinore, ndërkokë që masat e pyllëzimit të synojnë stabilizimin e humbjeve e tokës nga përblytjet (të zbatohet duke përdorur lloje të bimësise autoktone që i rezistojnë edhe përblytjeve).
- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos dëmtimin e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore që gjenden në territoret ku do të zbatohet ky plan.

- Të mbrohen vlerat natyrore të zonave në të cilat shtrihet studimi dhe të shmangen në maksimum dëmtimi i sipërsaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me kuadrin ligjor për mbrojtjen e natyrës, duke respektuar shkallën e mbrojtjes së zonës apo nënzonës së mbrojtur ku do të ndërhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve që gjenden në zonë, si dhe të komunikohet/bashkëpunohet me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura për të marrë masat e domosdoshme për mos cënimin e statusit të këtyre zonave, si dhe të merret në konsideratë përfshirja e Biosferes rajonale të Luginës së Vjosës në listën e pasurive botërore përmes programit UNESCO “Njeriu dhe Biosfera”.
- Të zbatohen masa zbutëse për zhvillimin e infrastrukturës, gjatë rehabilitimit/ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar “best practices”. Në asnjë rast nuk duhet të projektohet brenda, por as në afërsi të territorit të zonave të mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet në ajër dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitateet e llojeve nën mbrojtje.
- Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përparrësia së fazës së zbatimit të projekteve apo planeve specifike individuale të Planit, duhet të përfshihen masa që do të mundësojnë ruajtjen e korridoreve të kafshëve migratore, sidomos në rastin kur projektet që do të zbatohen mund të prekin zona të mbrojtura apo mund të ndodhen në afërsi të tyre.
- Në plan duhet të parashikohen masa që nxisin realizimin e projekteve të impianteve të trajtimit të ujравës të përdorur urbane dhe në një shkallë më të gjerë duke e shtrirë këtë masë edhe në aktivitetet e tjera industriale që krijojnë shkarkime ujrush industriale të ndotura dhe që ndikojnë sidomos në cilësinë e ujравës sipërsaqësore dhe nëntokësore. Të projektohet infrastrukturë bashkëkohore dhe afatgjatë të kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane.
- Të vihen në zbatim masat zbutëse e propozuara në raportin e VSM-së për minimizimin aposhmangien e ndikimeve negative në mjedis, gjatë implementimit të planit.
- Në tërësi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standartet e ruajtjes së peisazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e cilësisë së mjedisit të jenë parësore duke aplikuar “best practices”.
- Projektet që do të shfrytëzojnë burimet ujore nuk duhet të cënojnë statusin ekologjik të rrjedhave ujore apo nuk mund të zhvillojnë aktivitete që reduktojnë zonat e mbajtjes së ujut dhe të prodhojë ndikime kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemave të zonës.
- Masat e propozuara dhe aktivitetet e parashikuara në PPV të sigurojnë kohezion, efikasitet dhe qëndrueshmëri në parandalimin dhe reduktimin e impakteve në mjedis.
- Pavarësisht masave dhe rekomandimeve të kësaj Deklarate Mjedisore, gjatë zbatimit të planit është e detyrueshme të zbatohen kërkësat e legjislacionit mjedisor në fuqi;
- Shfaqja e elementeve të rindërtimit ekologjike të panjohur, në kohën që kjo Deklaratë Mjedisore është dhënë, sjell si detyrim rivlerësimin e saj.
- Për mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Deklaratë Mjedisore dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi ka sanksione ligjore dhe nënligjore.

Kërkësat përmes monitorimin mjedisor raportimin periodik në ministri gjatë zbatimit të Planit:

- Në rast se ministria, strukturat e saj të varësisë, njësítë e vet-qeverisjes vendore, apo edhe grupet e interesuara, përfshi edhe publikun, konstatojnë se plani nuk zbatohet në përputhje me vendimin përmiratimin e tij dhe nuk respekton kushtet e kërkësat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit, atëherë ministria pas verifikimit apo njofitimit nga palët konstatuese, njofton menjëherë autoritetin përgjegjës përmiratimin e planit dhe sipas rrithanave dhe i kërkon sqarimet përkatëse, apo ndalimin e menjëhershëm të zbatimit të planit, deri në sqarimin e situatës.
- Nëse Autoriteti Përgjegjës përmiratimin e planit vlerëson se gjatë zbatimit të tij, mund të ketë mundësi reale përmiratimin e planit apo njofitimit nga palët konstatuese, njofton menjëherë autoritetin përgjegjës përmiratimin e planit dhe sipas rrithanave dhe i kërkon sqarimet përkatëse, apo ndalimin e menjëhershëm të zbatimit të planit, deri në sqarimin e situatës.

përgjegjëse për mjedisin, që të nisin procesin dhe konsultimin palën e prekur nga ky plan dhe të ndërpresë zbatimin e tij deri në përfundim të konsultimeve ndërkufitare.

- Autoriteti propozues të hartoje Programin e Monitorimit Mjedisor gjatë zbatimit të planit, me synim mbledhjen e të dhënave për ndikimet konkrete dhe pasojat në mjedis gjatë zbatimit të tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutëse shtesë, që duhet të zbatohen për të garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky program të hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklaratës Mjedisore dhe të merret miratimi i autoriteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.
- Me qëllim lehtësimin e realizimit të programit të monitorimit mjedisor të planit mund të përdoren programe ekzistuese monitorimi, që përputhen me qëllimin e programit të monitorimit mjedisor të këtij plani.

Kërkesa për raportim mjedisor periodik

- Nëse pasojat në mjedis e shëndet, tejkalojnë standardet mjedisore në fuqi, atëhere ministria i kërkon autoriteteve miratuese e zbatuese të planit të merren masat e duhura për shmangien/minimizimin e ndikimeve negative, ose të vlerësohet edhe ndryshimi i planit, me qëllim që të përbushen standardet mjedisore.
- Bashkia Tepelenë, nën mbikqyrjen e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, që zbaton dhe mbikqyr zbatimin e PPV, duhet të hartoje periodikisht 1 herë në vit, një raport vjetor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit, të cilin duhet ta depozitojë pranë Ministrisë përgjegjëse për Mjedisin, jo më vonë se java e fundit e muajit nëntor.

Mosmiratimi i Planit të Përgjithshëm Vendor brenda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, sjell pavlefshmërinë e kësaj deklarate dhe procedura e VSM-së fillon nga e para.

